



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Shk.II.nr.1344/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përmbaremore të kreditorit sh.p.k, me seli në Prishtinë, rr.“....” nr..... me nr. biznesit, kundër debitorit sh.p.k, me seli në Obiliq rr. “....” Magj. Prishtinë – Mitrovicë, me NRB, përfaqësuar sipas autorizimit nga Nexhmedin Demolli, avokat në Prishtinë, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.689/2020 të dt. 26.07.2021, jashtë seancës me datën 24.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit sh.p.k, me seli në Obiliq, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.689/2020 të dt. 26.07.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.689/2020 të dt. 26.07.2021, ka vendosur si në vijim: I. Refuzohet si e pa bazuar prapësimi i debitorit sh.p.k, me seli në Obiliq, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbaremit numër P.nr.082/20 dt.10.06.2020, të lejuar nga zyra përmbaremore e përmbaremit privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë. II. Në rast të ankesës kundër këtij aktvendimi urdhërohet pala ankuese që konform nenit 78 par 1 të LPP-së, paraprakisht të deponoj garancinë në të holla në shumë prej 13.175.87 euro, si parakusht për parashtrimin e ankesës, në të kundërtën gjykata konform nenit 78 par 4 të LPP –së, do të konsideroj se ankesa nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbaremit ose urdhri përmbaremit nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbaremit, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, të anulohet aktvendimi i atakuar dhe urdhri Përmbaremit P.nr.082/20 të dt. 10.06.2020, të lëshuar nga përmbaremit privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë, ose të detyrohet kreditori

qe debitorit t'ia paguaj shpenzimet e përpilimit të ankesës në shumë prej 312.00 euro si dhe shpenzimet tjera të krijuara deri më tani në procedurën përmbarimore.

Ankesa i është dërguar në mënyrë të rregullt të autorizuarit së kreditorit, por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale– Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori sh.p.k, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit shpk, në bazë të dokumentit të besueshëm autentik – Faturave mujore të qeras me nr. të dt. 01.03.2018; dt. 03.04.2018; dt. 02.05.2018; dt. 01.06.2018, për shumën e detyrimit në vlerë prej 13.175.87 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e kalimit të afatit të pagesës së faturave e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përmbaruesi Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.082/20 të dt.10.06.2020, ka caktuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm – fatura e lartcekur, i plotëson kushtet për përmbarim.

Ndaj këtij urdhri me dt. 23.06.2020, ka paraqitur prapësim debitori, për shkak se propozimi për përmbarim është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së si dhe nuk përmban të dhënat e nevojshme sipas dispozitave të LPP –së, me propozim që gjykata propozimin për përmbarim ta refuzoj si të pa bazuar dhe ta anuloj urdhrin e lejuar të përmbaruesit privat duke aprovuar prapësimin e debitorit dhe duke e obliguar kreditorin ti paguaj shpenzimet për prapësim në shumë prej 312.00 euro, sipas tarifës së odës së avokatëve. Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit, me dt.26.06.2020, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet si e pathemeltë prapësimi i debitorit, ndërsa të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.082/20 të dt. 10.06.2020, i caktuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim Metaj sipas propozimit të kreditorit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.689/2020 të dt. 26.07.2021, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur me decidivisht sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se gjykata ka gjetur se në këtë çështje se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentet e besueshme – fatura me nr.... të dt. 01.03.2018..... dt. 03.04.2018; dt. 02.05.2018; dt. 01.06.2018, në bazë të cilave debitori ka obligim të pa përmbushur ndaj kreditorit në shumë prej 13.175.87 euro. Andaj, gjykata ka vlerësuar se urdhri për përmbarim i lejuar mbi bazën e faturës së lartcekur nuk është në kundërshtim me dispozitivin e nenit 29 të LPP –së, ngase i përmban të gjitha

tiparet e dokumentit të besueshëm të përcaktuar me këtë dispozitë dhe me dispozitën e nenit 30 të LPP –së, meqë u vërtetua se kredia është bërë e realizueshme pasi debitori ka pranuar faturën dhe nuk e ka përmbushur detyrimin. Pretendimet e debitorit në prapësim gjykata i ka refuzuar, për arsye se nuk i bashkangjitur prova, duke iu referuar nenit 69 par 4 të LPP –së, apo se ekziston ndonjëri nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP –së. Ndërsa ato të theksuara në prapësim janë të paqëndrueshme pasi që palët përmes dorëzimit pranimit të lokalit afarist nr..... të dt. 11.07.2018, e nënshkruar nga të dy palët janë marr vesh për mënyrën e shfrytëzimit sipas kontratës nr..... dt. 22.06.2016, andaj mosmarrëveshjet e tyre lidhur me pretendimet në prapësim, mund të shërbejnë në një procedurë tjetër por jo në procedurën përmbartimore, ku gjykata ka obligim ligjor që të vlerësoj faturën si dokument përmbartues dhe jo të lëshohet në çështje kontestuese mes palëve.

Prandaj, gjykata ka vlerësuar se urdhri përmbartimor P.nr.082/20 dt. 10.06.2020, i lejuar nga nga zyra përmbartimore e Përmbartuesit Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave përben bazën juridike për caktimin e përmbartimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 24 dhe 27 të LPP –së, për të qenë i përmbartueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbartim.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues nuk ka titull ekzekutiv, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbartimore, përkatësisht neni 29 par 1. nën par.1.3 dhe par 3 i cili përcakton se: “ *Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: fatura. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar ”. Gjithashtu neni 37 dhe 40 par.1 pika 3 i LPP-së, përcakton se propozimi për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë “originalin apo kopjen e vërtetuar e dokumentit të besueshëm”, e në rastin konkret fatura po ashtu edhe propozimi i përmbart të gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat e lartpërmendura, andaj si i tillë dokumenti i besueshëm përmbart tiparet e nevojshme të përmbartueshmërisë të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Debitori në prapësim nuk ka ofruar ndonjë argument apo provë me të cilën kishte me paraqitur ndonjë nga shkaqet që janë të parapara me nenin 71 të LPP-së.*

Duke u mbështetur ne nenin 69 par.4 te LPP *“baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me çka debitori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit, por edhe pretendimet e vetë debitorit në prapësim.

Pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se faturat nuk janë të nënshkruara nga ana e tij, dhe të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme, kjo gjykatë nuk i ka pranuar si të bazuara, kjo për faktin se këto fatura mbështeten në punë juridike pra derivojnë nga kontrata e qirasë nr..... dt. 22.06.2016, e lidhur mes palëve ndërgjyqëse dhe përmbushin të gjitha elementet e kërkuara me dispozitat e lartcekura. Nga kjo kontratë rezulton që debitori ka qenë në njohuri për ekzistimin e detyrimit për pagesën e faturave të qirasë për arsye se afati i kontratës për qiranë ka qenë nga dt. 01.07.2016 deri me dt. 01.07.2018, po ashtu edhe faturat janë lëshuar për periudhën brenda këtij afati si dhe nuk ka pasur denoncim të kontratës nga ana e debitorit, andaj, kjo gjykatë vlerëson pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë dhe se aktvendimi i ankimuar i shkallës së parë është në harmoni me dispozitat ligjore të lartcekura dhe si i tillë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Dhoma e shkallës së dytë, i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet tjera ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Dhoma e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka lejuar urdhrin për caktimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, P.nr.082/20 dt. 10.06.2020.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1344/22 dt.24.08.2022

Gjyqtari,
Krenar Berisha